AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. **Tiranë ___/___/2024**
Nr. Dok. 202400995/10

Lënda: *Rekomandim për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Këlcyrë për hartimin e një plani konkret për përmirësimin e kushteve të strehimit të banorëve dhe një vlerësimin serioz të mënyrës sesi trajtohen çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve në këtë Bashki.*

BASHKISË KËLCYRË

Të nderuar,

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Siç jeni në dijeni, nga komunikimet e mëparshme institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nisur nga kronika/lajmi i publikuar në median online "Top Channel" në emisionin "Fiks Fare", më datë 12.07.2024, me titull: ***"Familja nga Këlcyra me djalin tetraplegjik apel për***

ndihmë: Duam vetëm çatinë!"[1], ka regjistruar rastin dhe ka nisur hetimin administrativ lidhur me këtë çështje.

Në kronikën e transmetuar, morëm informacion lidhur me ankesën publike të familjes së sipërcituar, si më poshtë:

> *Familja H. nga Këlcyra me një dalë 24 vjeç tetraplegjik bën apel për ndihmë. Në kushte shumë të këqija ekonomike dhe me borxhe ata kërkojnë vetëm t'u ndërtohet çatia e shtëpisë, pasi çfarë bie jashtë hynë brenda. "Djali sa herë që ka reshje bën o maaa, o baaa iiiii" tregon z. H. i cili edhe ky është i sëmurë nga këmba. Bashkia nga ana tjetër shpjegon se e kanë ndihmuar familjen me aq sa kanë pasur mundësi, por për rikonstruksionin e çatisë me mundësitë e bashkisë sot për sot rikostruksioni nuk është i mundur.*

Në kuadër të hetimit administrativ për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor[2] Avokati i Popullit i ka kërkuar institucioneve vendore përgjegjëse shpjegime dhe informacion lidhur me situatën social ekonomike të familjes Hoxha dhe mundësitë për të ndihmuar këtë familje në nevojë për adresimin e problematikës së evidentuar sipas fushave të përgjegjësisë së tyre. Konkretisht:

1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër[3] na informon se:

Pas kryerjes së verifikimit social ekonomik në banesë, nga administratorët shoqëror të Bashkisë Këlcyrë rezultoi se familja H. është e përbërë nga katër anëtarë. Kryefamiljari trajtohet me pension pleqërie dhe bashkëshortja merr pagesën e kujdestarisë të djalit tetraplegjik i cili është përfitues i grupit të parë që prej vitit 2000. Familja jeton në kushte të vështira social-ekonomike. Familja H. i është drejtuar me kërkesë zyrtare Bashkisë Këlcyrë për rikonstruksionin e çatisë, në përputhje me kompetencat e pushtetit vendor.
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër i ka sugjeruar administratorit shoqëror mbështetjen e kësaj familjeje me ndihma nga ana e Bashkisë Këlcyrë dhe krijimit të mundësisë për ndihma nga donatorë të ndryshëm.

---

[1] https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=bBR-IKgZ-JA&embeds_referring_euri=https%3A%2F%2Ftop-channel.tv%2F&source_ve_path=MTY0OTksMjg2NjQsMjg2NjY&fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAAR3kMMjfZ6IW3pg6XhC36VVzqgkM4GVVZXdoQeN1e9Eq68W1p-x3u2Hzbdo_aem_7YzQrInGSFPfbbvZjjpApw
http://top-channel.tv/

2 Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: "Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe nenit 19 pika b, Ligji Nr.8454 , date 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku përcaktohet: "Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".
3 Shkresa nr.1197/1 Prot., datë 23.09.2024, "Kthim përgjigje".

2. Bashkia Këlcyrë nuk i ka kthyer asnjë përgjigje mbi këtë rast, shkresave të institucionit të Avokatit të Popullit[4], në mënyrë të përsëritur

***

Konsiderata të Avokatit të Popullit.

Për të përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëvë, anëtarë të grupeve në nevojë, lidhur me kushtet e tyre të vështira të jetesës, strehimin e varfërinë dhe për të siguruar që ata të jetojnë në përputhje me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, është e nevojshme të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare dhe nga kuadri i brendshëm ligjor dhe strategjik. Mungesa e kushteve minimale të jetesës së këtyre qytetarëve është një problem serioz që krijon premisat që anëtarë të këtyre grupeve të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Për të mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës për këto grupoe të margjinalizuara nevojitet kuptim, dedikim dhe koordinim ndërinstitucional, i cili ka një rëndësi thelbësore për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të këtyre qytetarëve.

E drejta për strehim është një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe si e tillë përfshihet në një numër të konsiderueshëm të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Deklarata Universale të Drejtave e të Njeriut, në nenin 25.1 të saj, parashikon që: "Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe të familjes së tij duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin".

Konventa të rëndësishme në nivel ndërkombëtar sanksionojnë rëndësinë e respektimit dhe garantimit maksimal të kësaj të drejte.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e regjimit tonë të brendshëm juridik, dhe jurisprudenca e pasur në këtë drejtim e GJEDNJ, sanksionon të drejtën për strehim si një të drejtë themelore të njeriut.

[4] Shkresë nr. K1/I82-2 Prot, datë 22.07.2024, "Kërkesë për informacion". Shkresë nr. K1/I82-4, datë 23.08.2024, "Kërkesë e përsëritur për informacion", Shkresë nr. K1/I82-8, datë 10.09.2024, "Kërkesë e përsëritur për informacion dhe shpjegime".

Konventa e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore, kërkon marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të nxitur realizimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Karta Sociale Europiane dhe Karta Sociale Europiane e Rishikuar, neni 16 "E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes cilëson; *Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tilla si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtashtme.*
" Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon: *"Të drejtën e strehimit. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat:*
-nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm;
-nxisin dhe zvogëlojnë mosstrehimin me qëllim eleminimin e plotë të tij;
-ofrimin e çmimeve të shtëpive që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme."

Sipas këtyre instrumentave ndërkombëtarë, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Sa më sipër, duhen pasur në konsideratë edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) për zbatimin e të cilave institucioni i Avokatit të Popullit kontribuon duke orientuar institucionet t'i qëndrojnë pranë qytetarëve më në nevojë, për të mos i rrezikuar pa ofrimin e shërbimeve. Një nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm është sigurimi i të gjithë qytetarëve, me prioritet shtresat në nevojë, për të patur të drejta të barabarta dhe qasje në shërbimet themelore. Deri në vitin 2030 duhet siguruar qasja në strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të arritshëm për të gjithë. Zbatimi i Agjendës 2030 "Për Zhvillimin e Qëndrueshëm"[5] është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për qytetarët. Angazhimi kryesor që "Asnjë të mos mbetet pas" përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

E drejta për strehim është sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 59, pika 1, gërma "b", lidhur me objektivat social, ku parashikohet shprehimisht se: "Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim". Nga ana tjetër sipas nenit 38 të Kushtetutës: "Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin e tij

[5] Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication, e aksesueshme në dhjetor 2015.

si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit", e drejtë kjo që kondicionohet me faktin se fillimisht duhet të kesh një banesë për strehim. Në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut cilësohen si: "të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme", duke u bërë bazë e rendit juridik të vendit tonë. Ky përcaktim sanksionon barazinë dhe ndalimin e diskriminimit për të gjithë individët që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Theksojmë se ligjvënësi ka vendosur mekanizmat ligjorë dhe mjetet proceduriale në dispozicion të bashkive/organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar që ato të vinë në ndihmë të shtresave në nevojë.
Legjislacioni i shërbimeve sociale në thelb synon plotësimin e nevojave të shtetasve dhe familjeve të varfra. Sidomos kur kemi të bëjmë me familje/individë në nevojë për mbështetje, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës është i rëndësishëm, me qëllim garantimin e mbrojtjes sociale, për identifikimin e vlerësimin e çdo rasti.

Ligji Nr. 22/2018 'Për strehimin social' dhe aktet nënligjore, përfaqësojnë një kapërcim të qenësishëm cilësor në mënyrën si perceptohet strehimi i përballueshëm, si adresohen grupet në nevojë, dhe si hartohen programet e veçanta të strehimit.
Ky ligj parashikon parimet për strehim të përshtatshëm[6], duke përcaktuar edhe kriteret që e klasifikojnë strehimin e përshtatshëm[7] si dhe llojet e programeve të strehimit[8].

Bashkitë vendosen në pozicion pro-aktiv në lidhje me ofrimin e strehimit social, dhe luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në identifikimin dhe hartëzimin e grupeve në nevojë, si dhe në identifikimin e mënyrave të financimit për strehimin e nevojshëm në mënyrë që t'u krijojë qytetarëve mundësitë për një jetë të përshtatshme e dinjitoze.

Për të adresuar problematikën e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, institucionet e pushtetit vendor si institucionet përgjegjëse, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve bazuar në parimin e subsidiaritetit.

Organet e qeverisjes vendore, përkundrejt ankuesve por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi duhet të garantojnë standardin e nevojshëm për qeverisje, garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve, siç është e drejta për strehim. Ato duhet tu krijojnë mundësi më efektive qytetarëve

6 Nenet 3-10, Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social".
7 Neni 4 "Parimet e strehimit të përshtatshëm", Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social".
8 Neni 11, Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social".

për të aplikuar në programet e duhura dhe tju sigurojnë atyre aksesin efektiv.

Nga ana tjetër, mirëqeverisja, e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, duhet të konsiderohet si një koncept prioritar në veprimtarinë e përditshme të organeve publike. Rritja e standardit të shërbimeve publike të ofruara nga organet e administratës në cdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communitaire. Një iniciativë që tregon angazhim në këtë drejtim është Dokumenti i politikave të standardeve të shërbimeve në Shqipëri, i cili shqyrton sfidat që hasen në përkufizimin e standardeve të shërbimeve publike, si dhe paraqet kornizën e përgjithshme dhe zgjidhjet praktike të politikave për të nxitur zhvillimin e standardeve të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve[9].

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe po ndjek në vazhdimësi këtë problematikë, e cila ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës e rrjedhimisht të drejtën themelore të njeriut, të njohur si "e drejta për jetën", e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës.

Për shkak të mungesës së zhvillimit në zona të caktuara ku qytetarët përballen me vështirësi strukturore, puna për ta duhet të jetë intensive dhe e vazhdueshme që të arrihet trajtimi i barabartë dhe adresimi i problematikave me të cilat ndeshen ata në përditshmërinë e tyre. Përpjekjet për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave duhet të jenë ndërshtetërore, pasi problemi është strukturor dhe sistemik.

Bashkia si institucioni në nivel lokal me afër qytetarëve[10] duhet të sigurojë mekanizmat ligjorë e financiarë për nxjerrjen e tyre nga mjerimi. Është në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkisë, si organ i pushtetit vendor, që të sigurojë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Kjo referuar edhe dispozitave të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e konkretisht neni 3 i të cilit përcakton: "Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose nëligje të tjera;
c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

9 Dokument politikash për Standardet e Shërbimeve Publike në Shqipëri- https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/532
10 Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 3,4,5,9.

d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative".

Në këtë kontekst, vlerësojmë se qasja ndaj familjeve/ individëve në nevojë dhe jo vetëm, që duhet të ketë bashkia si organ kyç i pushtetit vendor, më afër qytetarit se çdo organ tjetër, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre duhet të jëtë e tillë që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta.

Në vijim, Avokati i Popullit vlerëson se Bashkia Këlcyrë vazhdon të mbajë një qendrim qartësisht refuzues për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit. Ky qendrim vjen në kundërshtim të hapur me:

- pikën 4, të nenit 63, të *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,* ku parashikohet në mënyrë eksplicite se: "Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij";

- nenin 19/b të *Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit",* që parashikon se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin", si edhe paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.";

Qëndrimi i punonjësve të Bashkisë Këlcyrë është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efiçencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të Ligjit Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 1 të këtij Kodi.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se punonjësit e Bashkisë nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor në marrëdhënien me institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë për institucionin e Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efiçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm.
Në këtë kuptim, qasja refuzuese për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit, krijon hapësira për dyshime të arsyeshme se kjo sjellje është akoma më

e theksuar në marrëdhënien me qytetarët.

Parë në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme marrja e masave për një vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni i Bashkisë çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe shkëmbim të plotë dhe shterues të informacioneve të nevojshme bazuar në përcaktimet ligjore, për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.

Në përfundim, Avokati i Popullit në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive";

R E K O M A N D O N:

1. *Ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Këlcyrë, për hartimin e një plani konkret për përmirësimin e kushteve të strehimit të banorëve në këtë Bashki.*

2. *Marrjen e masave për të adresuar një zgjidhje përfundimtare për strehim të qendrueshëm dhe të përshtatshëm për familjen H., sipas parashikimeve të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" dhe akteve nënligjore përkatëse.*

3. *Marrjen e masave për koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe marrjen e masave për një vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni juaj çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe një shkëmbim të drejtë e shterues të informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje **brenda 30 ditëve nga data e dërgimit.**

Për, sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij në një afat të arsyeshëm dhe ligjor.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

K O M I S I O N E R

VILMA SHURDHA